



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



“Ulja e krimeve mjedisore nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të agjensive ligjzbatuese, në Parkun Kombëtar të Tomorrit”.

Dje, më datë 06.10.2016 u zhvillua në ISHMP trajnimi mbi krimin mjedisor në kuadër të programit ACHIEVE – REC Albania, financuar nga Bashkimi Evropian. Pas AdZM, cikli i trajnimeve në kuadër të forcimit të kapaciteteve të agjensive ligjzbatuese, u zhvendos në ambjentet e ISHMP- Berat.

Trajnerja, juristja Arsiola Dyrmishi prezantoi disa aspekte të legjislacionit evropian mbi mbrojtjen e mjedisit, veprimet/mosveprimet që përbëjnë krim mjedisor sipas legjislacionit evropian dhe krahasimin e legjislacionit shqiptar (legjislacioni sektorial, kuadër dhe penal mbi krimin mjedisor). Vëmendje e veçantë i'u kushtua implementimit të ligjit nga institucionet ligjzbatuese, midis të cilëve ISHMP si një institucion i ri, i cili reflekton vëmendjen e legjislatorit ndaj mbrojtjes së mjedisit.

Në kuadër të këtij institucioni u konkludua që është i nevojshëm konsolidimi i praktikës institucionale si dhe trajnimi dhe specializimi i inspektorëve në mënyrë që dosjet që përcillen në Prokurori të kenë provat e mjaftueshme me qëllim provimin e akuzës. Nga inspektorët u diskutua në lidhje me procedurat e organit të prokurorisë, të cilat sipas tyre janë të stërzgjatura dhe komplekse, çka i bën të hezitojnë për kryerjen e kallëzimeve, edhe pse ISHMP ka kryer disa kallëzime.

Trajnerja informoi inspektorët mbi procedurat e organit të prokurorisë si dhe detyrimet e secilit nëpunës në raport me ta. Problematikë mbetet gjithashtu ecuria e çështjes gjatë gjyqimit, për të cilat u dhanë disa rekomandime. ISHMP ka vendosur disa masa administrative gjorbë por pa mundur të bëjë ekzekutimin e tyre. U rekomandua kërkimi i shpeshtë i informacionit nga kreditori (ISHMP) të zyrat përmbarimore si dhe kërkimi i kamatvonesës. Në përfundim u diskutua mbi kundërvajtjet dhe veprat penale kundër mjedisit të parashikuar në Kreun IV të KPRSH “Veprat penale kundër mjedisit” duke analizuar tekstin e dispozitës penale si dhe duke konkluduar rreth nevojës për pasurim të figurave të veprave penale kundër mjedisit, në mënyrë që të kryhet harmonizimi i plotë i legjislacionit shqiptar me legjislacionin evropian, në kuadër të detyrimit të Republikës së Shqipërisë për harmonizimin e legjislacionit.



Arsiola Dyrmishi

Juriste

Organizata: “Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore” Berat

“Ky projekt zbatohet nga organizata “Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore” në kuadër të programit ACHIEVE – REC SHqipëri.



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



“Ky projekt zbatohet nga organizata “Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore”
në kuadër të programit ACHIEVE – REC SHqipëri.

